

Anton Çefa

TE GURI I HESHTJES

JEHE MELODISH

N' mendimin tim
Thërmohet një tingull guri
E vorbuj flake
Ngre në çdo pikël gjaku,
Mandej një mal me dhimbje
E jehe melodish
Ma të lashta se kohë e gurit.

TE GURI I HESHTJES

Me buzë të gurta
Heshtja m'i puthi orët
E ditët e netët.

Një jetë që po ndigjoj
Meloditë e heshtjes
Në gojë të memecës
Të gurit.

Heshtja ka tingull guri,
Kur fjala bahet gur
E koha gur.

E HODHA EMNIN NË PRILLIN E BLERTË

Si një gur peshe
E hodha emnin në prillin e blertë
E ra në dhetorin acar.

Letërsi

Në të rrejsha, reja e borës me gjoftë!
Ra në dhetorin acar.

Si pëllumbin
E ngrinë trillet e dimnit,
E ngrinë.

Tash po e gjurmoj si i shastisun
Me mundim deri te pika e gjakut.

KOHA JONË

Koha jonë
Asht vorr i hapun.

Çdo vorr i hapun
Nji të vdekun pret,
Thotë nji fjalë e urtë.

Koha jonë
Ka shijen e vdekjes në gojë.

NATË 1946

Si në nji lamsh gjaku
Hana
Mbledh rrezet e shpupurishuna
Nën shaminë e turbullt të mjegullës
E mezi ndriçon në pikë të natës.
Kualt hingllijnë të trembun
Në dritë-terrën e saj.
Thonë ndiejnë erën e vdekjes.

Me putrat e disprimit
Qejt gërdhishtin dheun.
Thonë ndiejnë erën e vdekjes.

Hungurima automatikësh
Në të zbardhun
Shartohen në trupin e njomë të ditës së re.

Letërsi

EMBLEMA

Po flet?
Shshsht, mos fol!
Fjala ka flatra
E Zeusi s'duron blasfemi.

Kanë tringëllim të përjetshëm
Tridhjetë paret,
Juda i ka veshët e gjatë
E përgjon ditë e natë.

Sot asht emblemë e jetës
Bisku i gjakut,
Emblemë pesëcepëshe.

SHKAMBI I NËNUJSHEM

Shkamb i nënujshëm
Mshehun prapa hijes tande,
Ti je aty
Që kur zu fill krijesa.
Me prapagojë më flet,
Në prapashpinë m'godet.

Veç fytyrë e veprës
Të trathton.
Po edhe ajo asht e nënujshme.

DIMEN

Dheun e mbulon
Bardhësia e mendimeve të borës.

E flokët e saj
Mbi shpirtin e qelqtë të dimnit
Me mija forma
Lulet i çelin të ngrita.

Letërsi

Andrra të dridhshme,
Të ftohta
Puçrizen mbi gishtat e degëve
Që presin pranverën.

ROSAT E EGRA

Në horizontet e mbylluna
Përhumbet e tretet ngadalë
Vizatimi gjeometrik i rosave të egra -
Trazim i përkohshëm
I qiellit gri të shpirtit dimnuer, qi tërhiqet i trembun
Nga mospërfillja e klithmave të tyne
Të lamtumirës.

MOTIV I DIKURSHËM SHKODRAN

Drini i lau kambët Kalasë
E dielli, tue u rrëxue mbas Taraboshit,
Ia fali lulkuqin e fundit
Të ditës.

Puthin aroma lulesh
Muret e oborreve të randueme nga shermasheku
E shtëpitë, të mbetuna në fyte blerimesh,
Krrusen
Nën peshën e lodhjes së mbramjes
E të qiellit në prendim.

Krismat e dyerve, që mbyllen njena mbas tjetrës,
Dhe të gjitha zhurmat tjera
Shuhen ngadalë në valët e liqenit.
E Shkodra flen.

Letërsi

DASHUNIA JOTE

Dashunia jote -
Fytyrë dhimbjeje në gurin e zemrës,
Profil gëzimi në valët e lumit.

Sa ma shumë qi gurin e lan vala
Aq ma tepër dhimbja po shkelqen.

SHPATORET E KUJTIMEVE

Shpatoret e kujtimeve
Mbi varre lulesh n'harrim
Nuk më shpojnë ma
Si një ditë.
As pjalmi i tyne
Nuk pllenon ma
Copëza jete.

Sa do ta dëshiroja xhixhillojën
E natës së maji n'ndriçim
Të rrenojave të mallit tim
Të dikurshëm!

Shënim:

Këto poezi - të shkrueme në kohën e diktaturës - janë nxjerrë nga vëllimi i pabotuem

"Te guri i heshtjes"